



Pranuar / Dorezuar Punjeve / Prilato Received / Delivery	09.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTFK	3352/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.470/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.470/2022 të datës 20.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër Vendimit me numër protokollit II-374 të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "*transferim i përkohshëm*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.470/2022 e datës 20.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokollit II-374 i datës 21.04.2022 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthejë ankuesin në pozitën e punës Menaxher i Prokurimi sipas Akt Emërimit me numër protokollit II/12 të datës 01.06.2015, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Obiliqit, më datë 20.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2945/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

Vendimit me numër protokoll II-374 të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, duke pretenduar së i njëjti është nxjerr me shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.05.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Obiliqit. Ndërsa Këshilli, më datë 31.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me dokumentacionin lidhur çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.05.2022 me numër protokoll 2945/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin më numër protokoll II-49 i datës 07.02.2017; Vendimin më numër protokoll II-374 të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Njoftimin e datës 20.04.2022 për ankuesin; Letër emërimit e datës 12.01.2000; Kontratën e Punës më numër protokoll 01-44/03 të datës 03.01.2003; Kontratën e punës më numër protokoll 01-29/06 e datës 03.01.2006; Kontratën e punës më numër protokoll 01-55/07 të datës 03.01.2007; Kontratën e Punës më numër protokoll 01-98/07 e datës 08.10.2007; Kontratën e Punës më numër protokoll 02-41/07 e datës 24.12.2007; Kontratën e Punës më numër protokoll II/58 e datës 01.01.2011; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me Nr. II/04 i datës 20.01.2014; Akt Emërimit me Nr. II/12 i datës 01.06.2015; Lista e pagave shkurt 2022; Certifikatën e datës 07.05.2002; Certifikatë e datës 15.03.2005; Certifikatën e profesionalizimit në Prokurim; Certifikatën e profesionalizimit në Prokurim me Nr.222/07; Certifikatën e profesionalizimit në Prokurim Nr.276 e vitit 2008; Certifikatën e profesionalizimit në Prokurim e vlefshme për vitin 2009, 2010, 2011-2013, 2017-2019; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim me Nr.363 e lëshuar në vitin 2020; Certifikatën 24-25.08.2005; Certifikatën e datës 04.05.2007; Certifikatën e datës 27.12.2006; Certifikatën për pjesëmarrje 23-24.04.2009; Certifikatën dhjetor 2007; Mirënjohje e datës 14.06.2002; Mirënjohje qershor 2016; Mirënjohje e datës 14.06.2019; Mirënjohje qershor 2020; Fletëlëshim me numër të historisë 33; Raportin Specialistit i datës 15.02.2022, 07.03.2022, 07.02.2022, 28.03.2022, 16.05.2022; Foto; Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit qershor 2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 31.05.2022; Përshkrimin e detyrave të punës Menaxher i Prokurimit datës 18.07.2014; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar i Pasurisë; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin datës 28.01.2021, 03.03.2022; Emailin e datës 20.04.2022 nga Emailin e datës 20.04.2022 nga dhe Emailin e datës 20.04.2022 nga

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokoll II/12 të datës 01.06.2015 është i punësuar në Komunën e Obiliqit dhe i njëjti ushtron pozitën e punës *Menaxher i Prokurimit/Njësia e Prokurimit*, në kuadër të Departamentit të Administratës së Përgjithshme, me koeficient 9.5 të pagës, ndërsa me datë 21.04.2022 Kryetari i

Komunës së Obiliqit me Vendimin me numër protokollit II-374 ka transferuar përkohësisht ankuesin nga pozita e Menaxherit të Prokurimit në pozitën e Zyrtarit për Pasuri për periudhë gjashtë muaj duke filluar nga data 21.04.2022, me koeficient 7.5 të pagës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që transferimi i tij është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke shtuar me tej se nuk është transferuar në kategori të njëjtë.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht neni 33 paragrafi 2 ka pacaktuar se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë. Rrjedhimisht nisur nga kjo bazë ligjore si dhe duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Menaxheri i prokurimit dhe pozitën e punës Zyrtar i pasurisë, Kolegji konstaton se pozita Menaxheri i Prokurimit hynë në kuadër të kategorisë së ulët drejtuese, pasi që kjo pozitë konsiderohet e barasvlershëm me pozitën e shefit të divizionit, ndërsa pozita Zyrtar i Pasurisë hyn në kategorinë e zyrtarëve profesional.

Ne funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua nenit 52 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; ... si dhe Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë konkretisht nenit 4 paragrafi 1 ku theksohet se : Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit, e si rrjedhojë Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh konstatimin lidhur me kategorizimin e pozitës së Menaxheri të Prokurimit dhe pozitës së Zyrtarit të Pasurisë, Kolegji konstaton se Vendimi për transferimin e përkohshëm të ankuesit me numër protokollit II-374 i datës 21.04.2022 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit është nxjerrë në kundërshtim të plotë me dispozitat materiale si me lartë, sepse transferimi i përkohshëm i ankuesit nuk është bërë në kategori të njëjtë dhe se vendimi nuk përmban ndonjë arsye pse është bërë transferimi i përkohshëm i ankuesit, kështu që mbi këto rrethana Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Po ashtu Kolegji verën se vendimi i goditur me ankesë është lëshuar nga Kryetari i Komunës së Obiliqit, gjegjësisht ky vendim është nxjerrë nga organi jo kompetent sepse bazuar në nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të

transferohet. Në këtë kontekst e në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë njësi përgjegjëse konsiderohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Andaj, bazuar si me lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke iu bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me numër protokoll II-374 të datës 21.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthejë ankuesin në pozitën "Menaxher i Prokurimit" sipas Akt Emërimit me numër protokoll Nr. II/12 të datës 01.06.2015 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.470/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

